



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org.Jedinica Org Unit	01
Nr.Prot: Broj Prot: Prot No	05-2660
Nr./ faqeve Br./stranica No. pages	- 04 -
Data: Datum: Date	21.04.2021
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**  
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health  
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 228/IV/2021

Datë:20.04.2021

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ Nr. 7, 01 mars 2019), nenin 8 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në nenin 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës (GZ Nr. 3/2020, 25 gusht 2020), nenin 9 paragrafi 1.3 dhe nenin 89 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi (GZ Nr. 13/2013, 07 maj 2020), në zbatim të Vendimit Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 për Shpalljen e Emergjencës së Shëndetit Publik dhe të pikës 42 dhe 42 të Vendimit Nr.01/07 të datës 18.04.2021 për Masat e Përgjithshme dhe të Veçanta për Kontrollin, Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19, nxjerr:

**V E N D I M**

**Për aprovimin e Udhëzuesit të përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në aviacionin civil**

1. Aprovohet Udhëzuesi i përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në aviacionin civil (verzioni 1.0).
2. Udhëzuesi është i obligueshëm për të gjithë personat dhe sektorët ndaj të cilëve zbatohet.
3. Shtojca e bashkangjitur këtij vendimi, është pjesë përbërëse e tij.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm që përmes Qarkores Informative të informoj të gjitha institucionet dhe palët e interesit për aprovimin e këtij udhëzuesi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Vendim i dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit;
- Të gjitha ministrive
- Sekretarit të Përgjithshëm të MSh;
- Departamentit ligjor të Msh;
- Divizionit për komunikim me publikun të Msh;
- Arkivit të MS

**Dr. Arben Vitia**  
**Ministër i Shëndetësisë**



**Shtojca 1:** Udhëzues i përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 (verzioni 1.0)



*Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health*

**UDHËZUES I PËRKOHSHËM  
APLIKIMI I MASAVE TË PËRGJITHSHME DHE TË  
VEÇANTA PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E COVID-  
19 NË AVIACIONIN CIVIL**

Prishtinë, Prill 2021

Verzioni 1.0

## Udhëzime specifike të parandalimit të përhapjes së COVID -19

### 1. Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC)

- Orari i punës duhet organizohet me staf në funksione esenciale, në koordinim me drejtorët e departamenteve dhe pas aprovimit të drejtorit të përgjithshëm.
- Mbajtja e pajisjeve personale mbrojtëse në objektin e AAC-së është e obligueshme.
- Dezinfektimi i objektit të AAC-së do të bëhet në intervale të caktuara kohore, sipas planit të hartuar paraprakisht.
- Kufizimi i kontaktit me palët e treta dhe shmangja/kufizimi i takimeve në grupe më të mëdha në kuadër të AAC-së.

### 2. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës 'Adem Jashari'

- Menaxhon rrjedhën e udhëtarëve para hyrjes në terminal, gjatë gjithë kohës së qëndrimit në aeroport, para nisjes në destinacionin e udhëtimit dhe gjatë mbërritjes nga aeroporti/porta ajrore e jashtme.
- Informon udhëtarët para mbërritjes në aeroport për rregullat/kushtet e nisjes në kontekst të situatës së krijuar me COVID-19.
- Kontrollon fluksin e udhëtarëve në hyrje të terminalit përmes bartjes së maskës dhe lejimit të futjes në terminal vetëm të udhëtarëve dhe/ose përcjellësve të lejuar për ndihmë gjatë procedurave në terminal para nisjes dhe/ose mbërritjes.
- Lehtëson procedurat para nisjes dhe gjatë mbërritjes, duke zvogëluar sa më pak kontaktin fizik ndërmjet udhëtarëve dhe punonjësve ofrues të shërbimeve në terminal si dhe kohën e qëndrimit në hapësirat e terminalit.
- Siguron distancën fizike prej 2 m ndërmjet udhëtarëve gjatë gjithë kohës së qëndrimit në terminal në nisje/mbërritje.
- Vendos shenjëzim në hapësira lidhur me mbajtjen e distancës.
- Siguron pastrimin e shpeshtë të sipërfaqeve të kontaktit fizik gjatë kalimit të udhëtarëve nëpër terminal (karrocave të bagazhit, mbajtësve të shkallëve etj) dhe ajrosjen e shpeshtë të të gjitha hapësirave të mbyllura përmes ventilimit.
- Siguron sasi të mjaftueshme të pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) për të gjithë punëtorët e aeroportit që ofrojnë shërbime në aeroport.

### 3. Agjensia e Shërbimeve të Navigimit Ajror – ASHNA

- Në hyrje të objektit duhet të vendosen shenjat e dukshme të rregullave të sjelljes për mbrojtje nga COVID 19 (mbajtja e distancës fizike, ndalimi i hyrjes në objekt pa maskë që mbulon gojën dhe hundën).
- Vendosja e dezinfektuesve për duar dhe maskave në hyrje të objektit dhe hapësirat e brendshme në vende të dukshme.
- Vendosja e dezinfektuesve për duar dhe alkoolit 60-70% në veturat që përdoren për punë në terren.
- Vendosja e dezinfektuesve për duar dhe alkoolit 60-70% për dezinfektim të paisjeve të punës në vendet ku ndodhen paisjet e Navigimit, Survejimit, Mikroprocesimit, Com-Metit, Klimatizimit dhe Tensionit të lartë.
- Puna në ASHNA duhet të zhvillohet me staf esencial.
- Sigurimi i kushteve për punë nga shtëpia për stafin jo esencial.
- Vendosja e alkoolit 60-70 % për dezinfektimin e mjeteve të punës (për stafin me veprim operativ) dhe të tjerët.
- Pastrimi i vazhdueshëm dhe ajrosja e ambientit të punës.
- Dezinfektimi i rregullt i të gjitha hapsirave të punës pas çdo rasti Covid pozitiv dhe të dyshuar.
- Dezinfektimi i vazhdueshëm i veturave që përdoren për punë në terren.

### 4. Federata Aeronautike Kosovës

- Meqenëse ka të bëj me një aktivitet rekreativo-sportiv individual që kryhet në ambient të hapur (fluturime me paraglajd) dhe pa ndërveprim fizik ndërmjet pjesëmarrësve gjatë zhvillimit të tij, Federata duhet të sigurohet që në fazat parapërgatitore të aktiviteteve të veta të marrë masa që pjesëmarrësit në gara/ushtrime me paraglajd të udhëtojnë në grupe të vogla, deri në katër pjesëtarë, duke zbatuar masat mbrojtëse.

### 5. Konsiderata ndaj stafit

- Nëse stafi i juaj dyshohet të ketë COVID-19, personi duhet të izolohet pavarësisht nëse ka simptoma apo jo.
- Nëse stafi i juaj ka qenë i ekspozuar ndaj COVID-19, personi duhet të qëndrojë në shtëpi dhe respektojë rekomandimet nga MSh (<https://msh.rks-gov.net/sq/>) dhe IKShPK (<https://niph-rks.org/>).

*Vërejtje: Verifikimi i zbatimit të këtyre masave bëhet në vazhdimësi dhe kryhet në intervale të ndryshme kohore nga AAC-ja si organ mbikëzrës dhe rregullator, përmes inspektimeve të rregullta apo ad-hoc në terren që kryhen nga inspektorët e AACK!*